



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1420/2022

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINE– Dhoma e Shkallës së Dytë, e përbërë nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit F... L.L.C me NUI dhe me numër te biznesit, me pronar J.V. nga Prishtina ndaj debitorit C... L.L.C me numër te biznesit dhe, me seli ne fshatin P-M....-Graçanicë me përfaqësueses J.J., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1185/2020 të datës 09.11.2020, jashtë seancës me datën 02.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË si e palejuar ankesa e debitorit C... L.L.C” me numër te biznesit dhe, me seli në fshatin P-M...., e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1185/2020 të datës 09.11.2020.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1185/2020 të datës 09.11.2020, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit C... L.L.C me numër te biznesit dhe, me seli ne fshatin P-M....-Graçanicë, te ushtruar kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit P.nr.303/2020 te datës 24.08.2020 lëshuar nga zyra e Përmbartueses Private Emine Sherifi-Lubeniqi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë. Ndërkohë Gjykata Themelore në Prishtinë ka nxjerr Aktvendim PPP.nr.1185/2020 te datës 26.01.2021 ku në pjesën e I të dispozitivit cakton garancionin në të holla, në shumën prej 1,420.00€, si parakusht për ankesën e parashtruar kundër aktvendimit PPP.nr.11585/20 dt.09.11.2020, në pjesën II urdhëron debitorin C... L.L.C, që të deponoj në llogari te veçantë të Këshillit Gjyqësor te Kosovës, përmes arkës se Gjykatës Themelore ne Prishtinë, garancionin në të holla, ne shumën prej 1,420.00€, në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit te këtij aktvendimi, dhe në pjesën III të dispozitivit përcakton se nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit si ne piken dy te dispozitivit, do te konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare.

Kundër Aktvendimit PPP.nr.1185/2020, të datës 09.11.2020, debitori ka paraqitur ankesë, për shkak se dokumenti i besueshëm në bazë të cilit është nxjerr urdhri për lejimin e përmbarimit nuk ka tipare të përmbarueshmëris, malli i ofruar nuk ka pasur kualitetin e dakorduar, dhe për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovoj si të bazuar, aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje. Konsiderojmë se pretendimi i kreditorit për realizimin e borxhit është i paqëndrueshëm bazuar në faktin se malli i ofruar nga kreditori me rastin e liferimit tek debitori nuk ka pasur kualitetin për të cilin palët ishin dakorduar në fillim. Debitori me kohë ka paraqit vërejtjet dhe brenda afateve të parapara në kuptim të dispozitave të LMD-së, me kërkesë që mallin me të meta kreditori ta zëvendësonte, por kreditoi asnjëherë nuk e kishte bërë një gjë të tillë. Faturat e lëshuara nuk kanë bazë juridike dhe nuk përmbajnë tipare të përmbarueshmërisë.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Fatlum Podvorica, me pretendimin se debitori nuk e ka paguar garancionin në të holla si parakusht për parashtrimin e ankesës, e që parashihet me nenin 78 të LPP-së. Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në ankesë se kinse dokumenti i besueshëm nuk ka tipare të përmbarueshmërisë sepse malli i ofruar nuk ka pasur kualitetin e dakorduar. Dispozitivi i aktvendimit nuk ka kundërthënie në brendinë e tij me arsyet aktvendimit. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konsideruar se fatura 020017 e datës 08.09.2017 është dokument i besueshëm dhe përbënë bazë juridike për caktimin e përmbarimit konform nenit 21 dhe nenit 29 të LPP, propozon që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe aktvendimin e shkallës së parë ta vërtetoj si dhe ta detyroj debitorin të paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 17.08.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Fatura nr.020017 e datës 08.09.2017 e pranuar nënshkruar nga debitori.

Përmbaruesja Private Emine Sherifi-Lubeniqi për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.303/20, të datës 24.08.2020, ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.020017 e datës 08.09.2017, në shumën e borxhit prej 1420 Euro.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin PPP.nr.1185/2020 të datës 09.11.2020 ka refuzuar propësimin e debitorit si të pabazuar me arsyetimin se fatura nr.020017 e datës 08.09.2017 është

dokument i besueshëm dhe përbënë bazë juridike për përmbarim konform nenit 21 dhe 29 të LPP dhe është përshtatshme për përmbarim, konsideron se debitori prapësimin e tij nuk e ka mbështetur në prova siç kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP, prandaj edhe në bazë të nenit 73 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Po ashtu kjo gjykatë me aktvendimin PPP.nr.1185/2020 të datës 26.01.2021 ka caktuar garancionin në të holla në shumën prej 1,420.00€, si parakusht për parashtrimin e ankesës kundër aktvendimit PPP.nr.1185/2020 të datës 09.01.2020, dhe ka urdhëruar debitorin C.... L.L.C që ta deponoj garancionin në shumën prej 1420.00€ në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi dhe nëse debitori nuk e deponon garancinë brenda afatit si në pikën II të dispozitivit do të konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare. Kjo gjykatë arsyeton se nën 78 par.4 të LPP përcakton se nëse garancioni nuk paguhet atëherë konsiderohet se nuk është dorëzuar fare ankesa nga pala ankuese në këtë rast debitori.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se me të drejtë gjykatë e shkallës së parë, ka obliguar debitorin të paguaj garancionin bankar si parakusht për ankesën, duke u referuar në dispozitivin ligjorë nga neni 78 paragrafi 1 të LPP-së, që parasheh: se *“Gjykatë e shkallës së parë, në rastet kur debitori dëshiron të parashtrij ankesë kundër vendimit me të cilin është refuzuar prapësimi i tij në lidhje me propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, urdhëron palën ankuese që të paguaj garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dëm të pariparueshëm palës ankuese dhe nëse dëmi është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë”*.

Në rastin konkret nga shkresat në lëndë, Dhoma e shkallës së dytë, nuk ka gjetur dëshmi se debitori ka deponuar garancionin në llogari të KGJK-së, siç urdhëron Gjykatë Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr.1185/20 dt.26.01.2021, apo ka bërë kërkesë për lirim nga pagesa e garancisë nga shkaqet e cekura si në dispozitivin e nenit 78 paragrafi 2 i LPP-së. Andaj bazuar në nenin 78 par.4 të LPP ku përcaktohet se *“nëse pala ankuese dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga Gjykatë, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese”*, Dhoma e shkallës së dytë vlerësoi se nuk mund të shqyrtohen pretendimet ankimore të debitorit, për arsye se ligjvënësi një rast të tillë e ka konsideruar sikurse nuk është paraqitur fare ankesa nga ana e debitorit.

Nga sa u tha më lartë u vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1420/22 me datë 02.11.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha